



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

KOMISIONERI PËR TË DREJTËN E INFORMIMIT DHE MBROJTJEN E TË
DHËNAVE PERSONALE
DREJTORIA E HETIMIT ADMINISTRATIV

Nr. 1224/prot.
13

Tiranë më 9.12.2020

VENDIM

Nr. 51, datë 9.12.2020

PËR KONTROLLUESIN "SGS AUTOMOTIVE ALBANIA" SHPK

Në mbështetje të neneve 29, 30 dhe 32 të ligjit nr.9887, datë 10.03.2008 "*Për mbrojtjen e të dhënave personale*" i ndryshuar (në vijim "*Ligji*"), neneve 77-112 të ligjit nr.44/2015 "*Kodi i Procedurave Administrative të Republikës së Shqipërisë*" (në vijim "*Kodi i Procedurave Administrative*"), si dhe provave të administruara në ngarkim të kontrolluesit "*SGS Automotive Albania*" SHPK (në vijim, "*Kontrolluesi*"),

KONSTATOVA SE:

Në zbatim të Urdhrit nr.154 datë 09.10.2020 të Komisionerit për të Drejtën e Informimit dhe Mbrojtjen e të Dhënave Personale (në vijim "*Komisioneri*"), u krye hetim administrativ pranë Kontrolluesit, me objekt::

- Zbatimi i ligjit nr. 9887, datë 10.03.2008 "*Për mbrojtjen e të dhënave personale*" i ndryshuar dhe akteve të miratuara nga Komisioneri në lidhje me mbledhjen, përpunimin, ruajtjen dhe sigurinë e të dhënave personale, gjatë kryerjes së aktivitetit nga kontrolluesi "*SGS Automotive Albania*" SHPK.

Komisioneri për të Drejtën e Informimit dhe Mbrojtjen e të Dhënave Personale, pasi shqyrtoi relacionin e hetimit administrativ, procesverbalin e konstatimit dhe provat e administruara gjatë ushtrimit të hetimit pranë Kontrolluesit, konstaton se:

1. Kontrolluesi ka për objekt të aktivitetit ofrimin e shërbimit të kontrollit teknik të detyrueshëm të mjeteve rrugore me motor dhe rimorkio të tyre, përmbushjen e të gjitha detyrimeve të parashikuara në Kontratën e Konçesionit "*Për Shërbimin e Kontrollit Teknik të Detyrueshëm të Mjeteve Rrugore*".

Kontrolluesi përpunon të dhëna personale për kategoritë e subjekteve të të dhënave "*punëmarrës*", "*punonjës të larguar*", "*kandidatë për punë*" dhe "*subjekte të cilët kryejnë*

kontrollin teknik të automjeteve". Të dhënat personale përpunohen në kuadër të marrëdhënies së punës dhe të ofrimit të shërbimit për kontrollin teknik të detyrueshëm të mjeteve rrugore. Të dhënat personale përpunohen manualisht, si dhe nëpërmjet instrumenteve elektronike.

2. Lidhur me procesin e përpunimit të të dhënave për kategoritë e subjekteve *punëmarrës* dhe *punonjës të larguar*, Kontrolluesi mbledh dhe administron në dosjet personale të punëmarrësve të dhëna personale të familjarëve të tyre (*të dhënat e gjendjes civile, certifikatë familjare*).

Zyra e Komisionerit vlerëson se Kontrolluesi, gjatë procesit të përpunimit të të dhënave, nuk ka respektuar parimin e mbrojtjes së të dhënave personale lidhur në mjaftueshmërinë e të dhënave personale, sanksionuar në germën "c" të pikës 1 të nenit 5 të Ligjit, në të cilin parashikohet se mbledhja dhe përpunimi i të dhënave duhet të lidhet me qëllimin e përpunimit dhe të mos e tejkalojnë këtë qëllim.

3. Lidhur me procesin e përpunimit të të dhënave për kategoritë e subjekteve *kandidatë për punë*, Kontrolluesi nuk ka parashikuar asnjë afat për kohën e ruajtjes së të dhënave personale për këtë kategori të subjekteve, duke i mbajtur në tejkalim të afateve të nevojshme për qëllimin për të cilin ato janë grumbulluar dhe/ose përpunuar, kjo në kundërshtim me parimet e mbrojtjes së të dhënave personale sanksionuar në germën "d" të pikës 1 të nenit 5 dhe nenit 6 të Ligjit dhe Udhëzimin nr. 42, datë 22.07.2014, të Komisionerit për "*Përpunimin e të dhënave personale të kandidatëve për punë*" i ndryshuar (në vijim, "*Udhëzimi nr. 42*").

Zyra e Komisionerit vlerëson se Kontrolluesi ka detyrimin të përpunojë të dhënat personale për aq kohë sa ekziston qëllimi për të cilin janë përpunuar të dhënat personale. Në momentin që qëllimi ka përfunduar është e nevojshme që Kontrolluesi, vetë ose nëpërmjet delegimit të një pale të tretë në cilësinë e përpunuesit, të realizojë shkatërrimin e tyre, në të kundërt përpunimi i mëtejshëm i të dhënave konsiderohet i paligjshëm.

4. Të dhënat sensitive (shëndetësore) të punonjësve, të administruara nëpërmjet kartelës shëndetësore, ruhen në ambientet e zyrës së burimeve njerëzore duke mos marrë, midis të tjerash, masa organizative dhe fizike në gjendje që të garantojnë të dhënat. Këto të dhëna sensitive përpunohen në kundërshtim me parimet dhe rregullat e parashikuara në Udhëzimin nr. 11, datë 08.09.2011 të Komisionerit mbi "*Përpunimin e të dhënave të punonjësve në sektorin privat*" i ndryshuar (në vijim, "*Udhëzimi nr. 11*").

Zyra e Komisionerit vlerëson se punëdhënësi është i detyruar të marrë masa sigurie (neni 27 i Ligjit) për mbrojtjen e të dhënave personale të punonjësve që përpunohen në fushën e marrëdhënies së punës, duke i kushtuar vëmendje të veçantë të dhënave sensitive. Të dhënat sensitive duhet të ruhen të ndara nga çdo e dhënë tjetër personale e punonjësit duke vendosur rregulla të posaçme të dedikuara mbrojtjes së të dhënave sensitive dhe shëndetit të punonjësit. Këto të dhëna duhet të mbahen të ndara në mënyrë që mos të lejojnë një konsultim të padëshiruar gjatë aktivitetit të zakonshëm administrativ.

5. Kontrolluesi disponon kontrata me palë të treta. Në dispozitat e kontratave në fjalë nuk parashikohen detyrimet e palëve mbi përpunimin e të dhënave personale, në kundërshtim me parashikimet në nenin 20 të Ligjit dhe Udhëzimit nr. 19, datë 03.08.2012 të Komisionerit “*Mbi rregullimin e marrëdhënieve mes kontrolluesit dhe përpunuesit në rastet e delegimit të përpunimit të të dhënave dhe përdorimin e një kontrate tip në rastet e këtij delegimi*” i ndryshuar (në vijim, “*Udhëzimi nr. 19*”);

Zyra e Komisionerit vlerëson se, në rastet e delegimit të përpunimit të të dhënave dhe/ose një shërbimi, Kontrolluesi duhet të sigurohet që përpunuesi të garantojë përpunim të ligjshëm dhe të sigurt të të dhënave. Detyrimet e përpunuesit për përpunimin e të dhënave personale, parashikohen në nenin 20 të Ligjit dhe rregullohen me aplikimin e Udhëzimit nr.19.

6. Nga verifikimi i kryer në regjistrin elektronik dhe në protokollin e Zyrës së Komisionerit, si edhe nga hetimi administrativ i ushtruar, rezultoi se Kontrolluesi ka përmbyshur detyrimin për njoftim në zbatim të nenit 21 të Ligjit.

Nga ana tjetër, nga analizimi i përmbajtjes së njoftimit, rezultoi se Kontrolluesi nuk ka kryer përditësimin përkatës për ndryshimin e gjendjes së njoftimit të përpunimit të të dhënave, sa i përket:

- (i) Deklarimin në rubrikën 3, “*Kategoritë e subjekteve të të dhënave personale që përpunohen*”, të tilla si “*kandidatë për punë*” dhe “*punonjës të larguar*”;
- (ii) Deklarimin në rubrikën 5, “*Të dhënat sensitive që përpunohen*”, të tilla si “*shëndeti*”;
- (iii) Deklarimin në rubrikën 7, “*Marrësi i të dhënave Personale*” për subjektet marrëse si dhe për të gjithë marrësit, subjekte publike në të cilat Kontrolluesi në zbatim të detyrimeve ligjore përhap të dhëna personale;
- (iv) Deklarimin në rubrikën 9, “*Mjetet e përpunimit të të dhënave*” për përpunimin e të dhënave në mënyrë manuale.

Zyra e Komisionerit vlerëson se realizimi i detyrimit për përditësimin e ndryshimit të gjendjes së njoftimit të përpunimit të të dhënave është i rëndësishëm, pasi i jep mundësinë subjekteve të të dhënave që të informohen për përpunimin e të dhënave të tyre, nga ana e Kontrolluesit, si dhe për realizimin e detyrimeve ligjore të Kontrolluesit. Kjo i jep mundësi reale subjekteve të të dhënave për të ushtruar të drejtat e tyre sipas Ligjit.

7. Kontrolluesi nuk disponon “*Rregullore për mbrojtjen, përpunimin, ruajtjen dhe sigurinë e të dhënave personale*”, në të cilën të parashikohen rregulla specifike mbi mënyrën e përpunimit të të dhënave, sigurinë e të dhënave, afatet e mbajtjes së të dhënave, të drejtat e subjekteve, etj. në kundërshtim me parashikimet e nenit 27 të Ligjit dhe Vendimit nr. 6 datë 05.08.2012 të Komisionerit “*Për përcaktimin e rregullave të hollësishme për sigurimin e të dhënave personale*” (në vijim “*Vendimi nr. 6*”).

Zyra e Komisionerit vlerëson se hartimi i një *“Rregulloreje specifike për mbrojtjen, përpunimin, ruajtjen dhe sigurinë e të dhënave personale”*, në të cilën të parashikohen rregulla dhe procedura organizative specifike mbi mënyrën e përpunimit të të dhënave personale (për çdo kategori subjekti të dhënash), sigurinë e të dhënave, afatet e mbajtjes së të dhënave, etj., konsiderohet një detyrim shumë i rëndësishëm në zbatim të nenit 27 të Ligjit, pasi shmang pasojat e rënda që mund të vijnë për subjektet e të dhënave.

8. Kontrolluesi nuk ka ndërmarrë masa konkrete në kuadër të trajnimit të punonjësve që kanë akses dhe përpunojnë të dhëna personale, lidhur me legjislacionin në fuqi për mbrojtjen e të dhënave personale. Rezulton mosplotësim i detyrimeve në lidhje me ngritjen, administrimin dhe mirëmbajtjen e sistemit të menaxhimit së sigurisë së informacionit (SMSI) lidhur me mbrojtjen e të dhënave personale, të parashikuara nga Udhëzimi nr. 47, datë 14.09.2018 *“Për përcaktimin e rregullave për ruajtjen e sigurisë së të dhënave personale të përpunuara nga subjektet përpunuese të mëdha”* (në vijim, *“Udhëzimi nr. 47”*).

Zyra e Komisionerit vlerëson se, për shkak të cilësisë si subjekt përpunues i madh, si dhe për shkak të natyrës së veprimtarisë që ushtron, e cila kërkon masa të shtuara teknike dhe organizative për garantimin e sigurisë së të dhënave personale, Kontrolluesi është i detyruar të krijojë, mirëmbajë dhe administrojë SMSI në përputhje me parashikimet e Udhëzimit nr. 47.

SMSI për mbrojtjen e të dhënave personale duhet të bazohet në standardin ISO/IEC 27001, siç parashikohet në nenin 5 të Udhëzimit nr. 48, datë 14.09.2018, të Komisionerit *“Për certifikimin e sistemeve të sigurisë së informacionit, të dhënave personale dhe mbrojtjes së tyre”* (në vijim, *“Udhëzimi nr. 48”*), si dhe është një sistem i certifikueshëm, për qëllime përputhshmërie me standardin e sipërpërmendur, vetëm nga organizma të akredituar dhe autorizuar sipas parashikimeve të Udhëzimit nr. 48.

Në përfundim të hetimit administrativ, referuar provave dhe konstatimeve në vend, grupi i hetimit administrativ hartoi procesverbalin përkatës dhe, në respektim të së drejtës për t’u dëgjuar, në zbatim të neneve 87-89 të Kodit të Procedurave Administrative, Kontrolluesi është ftuar të marrë pjesë në seancë dëgjimore, përpara marrjes së vendimit përfundimtar nga ana e Komisionerit.

Përfaqësuesi i Kontrolluesit është paraqitur në seancën dëgjimore të organizuar nga Zyra e Komisionerit, ka pranuar shkeljet e konstatuara dhe ka deklaruar angazhimin për rikuperimin e shkeljeve të konstatuara gjatë hetimit administrativ të ushtruar.

Si përfundim, shkeljet e konstatuara gjatë ushtrimit të hetimit administrativ përbëjnë kundërvajtje administrative, në kuptim germave “a”, “ç”, “d” dhe “dh” të pikës 1 të nenit 39 të Ligjit, si dhe sanksionohen me gjobë si më poshtë:

a) kontrolluesit, që përdorin të dhëna personale në kundërshtim me kreun II “Përpunimi i të dhënave personale”, dënohen me 10 000 deri në 500 000 lekë;

c) kontrolluesit ose përpunuesit që nuk përmbushin detyrimet e përcaktuara në nenin 20 të këtij ligji, dënohen me 10 000 deri në 300 000 lekë;

d) kontrolluesit, që nuk përmbushin detyrimin për të njoftuar, sipas përcaktimit në nenin 21 të këtij ligji, dënohen me 10 000 deri në 500 000 lekë;

dh) kontrolluesit ose përpunuesit, që nuk marrin masat e sigurisë së të dhënave dhe nuk zbatojnë detyrimin për ruajtjen e konfidencialitetit, të përcaktuara përkatësisht në nenet 27 dhe 28 të këtij ligji, dënohen me nga 10 000 deri në 150 000 lekë;

Në bazë të pikës 2, të nenit 39, të Ligjit, personat juridikë, për kundërvajtjet e mësipërme administrative, dënohen me dyfishin e gjobës së përcaktuar në pikën 1 të këtij neni.

Për zgjedhjen e masës së gjobës, Zyra e Komisionerit ka parasysh faktin se shkeljet e konstatuara janë serioze. Ato lidhen me garantimin e parimeve dhe përpunimin e ligjshëm të të dhënave. Gjithashtu, vendimi i Komisionerit bazohet në mënyrën e reagimit të kontrolluesit për rikuperimin e shkeljeve të konstatuara.

PËR KËTO ARSYE:

Në zbatim të neneve 5, 6, 20, 21, 27, 29, 30, 39 (pika 1, gërmat “a”, “ç”, “d” dhe “dh”) si dhe nenet 40 dhe 41 të ligjit,

V E N D O S A:

1. Dënimin e kontrolluesit me gjobë në vlerën 400 000 (katërqind mijë) lekë, për shkelje të detyrimeve të përcaktuara në Kreun II të Ligjit;
2. Dënimin e kontrolluesit me gjobë në vlerën 200 000 (dyqind mijë) lekë, për shkelje të detyrimeve të përcaktuara në nenin 20 të Ligjit;
3. Kontrolluesi, të ketë në vëmendje përpunimin e të dhënave personale në përputhje me detyrimet e përcaktuara në Kreun II të Ligjit;
4. Kontrolluesi, të përfshijë në marrëveshjet me përpunuesit, detyrimet sipas parashikimeve të nenit 20 të Ligjit dhe Udhëzimit nr. 19;
5. Kontrolluesi, të plotësojë detyrimin për përditësimin e njoftimit, lidhur me ndryshimin e gjendjes së përpunimit të të dhënave personale për të cilat është përgjegjës, në zbatim të neneve 21 dhe 22 të Ligjit;
6. Kontrolluesi, në zbatim të nenit 27 të Ligjit, të hartojë rregulloren e brendshme në të cilën të parashikohen masa konkrete teknike dhe organizative për mbrojtjen e të dhënave personale, mënyrat e përpunimit të të dhënave, të drejtat e subjekteve të të dhënave, etj;
7. Kontrolluesi, me qëllim garantimin e sigurisë së të dhënave personale duhet të zbatojë detyrimet e përcaktuara në të Udhëzimit nr. 47, lidhur me krijimin, mirëmbajtjen dhe administrimin e Sistemit të Menaxhimit të Sigurisë së Informacionit (SMSI) për mbrojtjen e të dhënave personale.

SMSI për mbrojtjen e të dhënave personale duhet të krijohet në përputhje me standardin ISO/IEC 270001, siç parashikohet në nenin 5 të Udhëzimit nr. 48, si dhe çertifikohet, për qëllime përputhshmërie me standardin në fjalë, nga organizma të akredituar dhe autorizuar në përputhje me dispozitat e këtij udhëzimi.

Subjekti kontrollues, në zbatim të pikës 42 të Udhëzimit nr. 47, depoziton pranë Zyrës së Komisionerit kopje të çertifikatës së përputhshmërisë.

8. Në zbatim të pikës 1 të nenit 32 të ligjit, të përmbushen detyrimet sipas këtij akti brenda afateve si vijon:
- (i) brenda 15 ditëve, detyrimet e parashikuara në pikën 4;
 - (ii) brenda 15 ditëve, detyrimet e parashikuara në pikën 5;
 - (iii) brenda 30 ditëve, detyrimet e parashikuara në pikën 6;
 - (iv) brenda 45 ditëve, detyrimin e parashikuar në pikën 7;

Afatet e sipërpërmendura fillojnë nga data e marrjes dijeni të këtij akti;

9. Kontrolluesi të njoftojë Komisionerin për masat e marra.
10. Gjoha arkëtohet nga kundërvajtësi në Buxhetin e Shtetit, jo më vonë se 30 (tridhjetë) ditë nga komunikimi i këtij Vendimi. Me kalimin e këtij afati, ky Vendim kthehet në titull ekzekutiv dhe ekzekutohet në mënyrë të detyrueshme nga Zyra e Përmbartimit.
11. Kundër këtij Vendimi mund të bëhet ankim në Gjykatën Administrative të Shkallës së Parë Tiranë, brenda 30 (tridhjetë) ditëve nga komunikimi i këtij Vendimi.

Ky Vendim u shpall sot më 9.12.2020.

KOMISIONERI

Besnik Dervishi

